




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-6871/23 datë: 10.03.2023



Npi -- 01/85 datë: 15.03.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d), nenin 14 dhe 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neni 7 paragrafi (1 dhe 3) si dhe neni 21 i Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092; Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.06-350/02-0003316/23 të datës:02/02/2023, të Musli Musollit nga fshati Pjetërshticë, i cili në emër të banorëve të lagjeve të fshatit Pjetërshticë ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, që ti lejohen $S=500m^2$ sipërfaqe me qëllim të ndërtimit të një “Objekti për Ngushllime” për nevoja të Komunitetit të fshatit Pjetërshticë, në pjesën e Ngastrës Kadastrale, numër P-72809064-01514-1, Zona Kadastrale – Pjetërshticë, Evidentuar Pasuri e Komunës së Shtimes.

Kuvendi i Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, dhe Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DESTINIMIN E PRONËS KOMUNALE PËR AKTIVITETE TË NGUSHLLIMEVE TË KOMUNITETIT TË FSHATIT PJETËRSHTICË

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më datën 15.03.2023, unanimisht miratoi vendimin që t’i lejoj komunitetit të fshatit Pjetërshticë për ta shfrytëzuar përkohësisht, pjesën e ngastrës kadastrale me numër P-72809064-01514-1, me një sipërfaqe prej $S=500m^2$ në Zonën Kadastrale – Pjetërshticë, Evidentuar Pasuri e Komunës së Shtimes, me qëllim të ndërtimit të një “Objekti për Ngushllime” për nevoja të Komunitetit të fshatit Pjetërshticë.

II

Sipërfaqja prej 5 (pesë) ari tokë komunale, në pjesën e Ngastrës Kadastrale me numër P-01514-1, Z.K-Pjetërshticë, mund të shfrytëzohet nga komuniteti i fshatit Pjetërshticë përkohësisht, në afat të pa caktuar, deri në momentin kur Komuna ka ndonjë ineteres të përgjithshëm më të rëndësishëm.

III

Sipërfaqja prej 5 (pesë) ari tokë komunale, në pjesën e Ngastrës Kadastrale me numër P-01514-1, nuk i ndërrohet pronari, dhe nuk ndryshohet statusi i pronës, por vetëm do të shfrytëzohet përkohësisht nga komuniteti për ndërtimin e një objekti për ngushllime me leje të Drejtorisë për Planifikim, Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.

IV

Kuvendi i Komunës së Shtimes, rezervon të drejtën që në rast se Komuna ka ndonjë ineteres të përgjithshëm më të rëndësishëm të anulojë këtë vendim, dhe prona të destinohet për qëllim tjetër. Komuna nuk merr përsipër kompensimin e investimeve të bëra në këtë parcelë.

V


Autorizohet Ekzekutivi i Komunës, që duke u bazuar në këtë vendim dhe aktet pozitive në Kosovë, të kryej punët gjeodezike për përkufizimin e pjesës të ngastrës kadastrale si dhe të përcjellë implementimin e këtij vendimi.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

VII

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi